

PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË LËNDËS “TIK”



Program orientues

Koordinator:
Eriksen Mersinllari

2024-2025

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT.....	4
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	6
Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar	7
Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AMU dhe për AML.....	14
Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur	28
Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML	29
Kriteret e vlerësimit të orës mësimore.....	45
Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular	53
Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	55
Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	65

HYRJE

Mësuesi është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Një mësuesi, për të qenë i aftë në punën e tij, nuk i duhet të zotërojë vetëm lëndën, por edhe të dijë ta transmetojë atë sa më lehtësisht te nxënësit, nëpërmjet metodologjive bashkëkohore. Mësuesit punojnë me përgjegjshmëri dhe integritet, kanë njohuri të forta përmbajtësore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, zhvillojnë dhe përditësojnë njohuritë nëpërmjet vlerësimeve dhe vetëvlerësimeve të vazhdueshme, ndërtojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe bashkëpunojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.


Mësimdhënia e TIK-ut kërkon që mësuesit të përmirësojnë vazhdimisht aftësitë dhe njohuritë e tyre për të krijuar një mjedis më të përshtatshëm për mësimnxënie efektive. Një mësues i lëndës së TIK-ut duhet të jetë i aftë të shpjegojë koncepte komplekse në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke përdorur metoda të ndryshme, si mjete vizuale, shembuj praktikë dhe aplikime nga jeta reale. Këto metoda ndihmojnë nxënësit të lidhen më mirë me përmbajtjen dhe të kuptojnë përdorimin praktik të teknologjisë.

Përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional, mësuesit e TIK-ut kanë mundësinë të qëndrojnë të përditësuar me ndryshimet teknologjike dhe të njohin zhvillimet e fundit që mund të përmirësojnë procesin e mësimdhënies. Kjo jo vetëm që i lejon ata të ofrojnë përmbajtje të përditësuar dhe të përshtatur me nevojat e tregut, por gjithashtu ndihmon në krijimin e një mjedisi mësimor më dinamik dhe angazhues për nxënësit.

Ky angazhim për përmirësim të vazhdueshëm dhe për një qasje të përshtatshme mësimore e bën mësuesin një udhëheqës të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi pozitiv për përvetësimin e njohurive dhe aftësive të reja. Një proces i rëndësishëm i zhvillimit profesional për mësuesit e TIK-ut është edhe marrja e shkallës së kategorisë së kualifikimit. Për të ndihmuar mësuesit në këtë drejtim, është hartuar “Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës ‘TIK’”.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen:

- për kandidatët e kategorisë “**Mësues i kualifikuar**”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës



mësimore të hapur dhe vlerësimit me test të informatizuar sipas lëndëve/profileve dhe niveleve përkatëse;

- për kandidatët e kategorisë “***Mësues specialist***”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës;
- për kandidatët e kategorisë “***Mësues mjeshër***”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.

QËLLIMI I PROGRAMIT


Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së TIK-ut është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të lëndës së TIK-ut në për zhvillimin e tyre profesional dhe për marrjen e kategorive të kualifikimit.
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është i detyruar dhe i unifikuar, për mësuesit që do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.


Programi ka për qëllim që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë risitë më të fundit në sistemin arsimor parauniversitar;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve, për përdorimin e aftësive digjitale në procesin mësimor përfshirë edhe inteligjencën artificiale, qasjen STEM etj.;
- të tregojë përgjegjëshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësi shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet global që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin,



çështjet e barazisë gjinore, sigurisë kibernetike etj., me qëllim ndergjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;

- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar; të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit.



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në tre kapituj, si më poshtë:

Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar. Në këtë rubrikë përfshihen, kompetencat profesionale dhe rezultateve e pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional për realizimin e testit të informatizuar, si edhe modele të pyetjeve për lëndën e TIK-ut në secilin nivel arsimor : *arsim i mesëm i ulët (AMU)* dhe *arsim i mesëm i lartë (AML)*.

Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për organizimin e orës së hapur mësimore, tre modele orësh mësimore për lëndën e TIK-ut në nivelet arsimore *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për zhvillimin e projektit kurrikular, dy modele projektesh kurrikulare për lëndën e TIK-ut në nivelet arsimore *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të projektit kurrikular.

Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar

Testi i informatizuar i vlerësimit të kualifikimit përbëhet nga dy pjesë:

- a) Pjesa e parë përmban, zbatimin e programeve përkatëse lëndore dhe planifikimin e lëndës, mjedisin e të nxënit, metodologjitë efektive të mësimdhënie - nxënies në përgjithësi dhe të lëndës përkatëse, vlerësimin dhe arritjet e nxënësve, aspekte të etikës dhe komunikimit të mësuesit në institucionin arsimor parauniversitar në mjediset e institucionit, si dhe aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- b) Pjesa e dytë përfshin aspekte të zbatimit të përmbajtjes shkencore të lëndës në situata praktike nga jeta reale.

Programi i testimit të informatizuar është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- programe lëndore të lëndës TIK ;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënie – nxënie të lëndës;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të lëndës së TIK-ut.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

FUSHA “PROGRAME LËNDORE TË TIK-ut”

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të TIK-ut në shkollë” Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i TIK-ut:</i> • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; • përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; • harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e programit; • kategorizon rezultatet e të nxënit e programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit; • tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të TIK-ut);	• Korniza Kurrikulare. • Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX. • Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII. • Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X-XII.

- përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit;
- siguron informacion që demonstroi lidhjen e TIK-ut me shkencat e tjera dhe me jetën reale.

FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”

Kompetenca I “Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e TIK-ut”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i TIK-ut:</i> • demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; • përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; • demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; • identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); • planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta; • demonstroi qëndrim pozitiv ndaj lëndës së TIK-ut;	• Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së TIK-ut në arsimin e mesëm të ulët. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së TIK-ut në arsimin e mesëm të lartë.

• edukon të nxënësit dashurinë dhe kërshërinë ndaj lëndës së TIK-ut; • motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; • krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; • punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.	
Kompetenca II “Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e TIK-ut”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i TIK-ut:</i> • për zgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar; • përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; • planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; • përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; • përdor aplikimet teknologjike në mësimdhënien – nxënien e lëndës së TIK-ut; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • shpjegon parimet e hartimit të një detyre përmbledhëse për nxënësit.	• Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), ASCAP. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së TIK-ut në arsimin e mesëm të ulët. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së TIK-ut në arsimin e mesëm të lartë. • Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.

Kompetenca III “Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i TIK-ut:</i> • prezanton materiale duke përdorur software të ndryshëm aplikativë; • nxit nxënësit të bëjnë prezantime në TIK duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; • gjen dhe përdor materiale nga website të sigurta dhe të besueshme për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; • përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së TIK-ut apo në projekte kurrikulare të integruara, të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga interneti.	• Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. • Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së TIK-ut që përdoren në klasat VI - IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X - XII të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie. • Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP. • Literaturë që ka për fokus kryesor përdorimin e programeve kompjuterike.

FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”	
Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i TIK-ut:</i> - njih rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	- Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. - Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar.

FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”	
Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i TIK-ut:</i> njih rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe;	Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

- demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.

FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së TIK-ut” <i>Mësuesi i TIK-ut:</i> • dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e TIK-ut në klasat VI-IX dhe X-XII; • përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve të TIK-ut në klasat VI-IX dhe X-XII; • përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehjeve; • dallon ndërvlerësinë e koncepteve të TIK-ut nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera; • zgjidh me saktësi dhe me mënyra të ndryshme ushtrime, situata në TIK, të cilat përdorin konceptet dhe aftësitë e programeve në klasat VI-IX dhe X-XII; • përdor informacion të saktë e bindës për vlerat përdoruese të TIK-ut në shkencat tjera dhe në jetën e përditshme.	• Programe dhe tekste të lëndës së TIK-ut për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë.

Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AMU dhe për AML

Model pyetjesh të lëndës teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK) - Arsimi i Mesëm i Ulët

A. Programi lëndor

1. Cila nga njohuritë e mëposhtme gjendet në shkallën e katërt, në tematikën “Hyrje në programim dhe Excel” në programin e TIK-ut për klasën e tetë?


A) njohja dhe zbatimi i konceptit të referencës relative, absolute dhe mikse
B) njohja e formateve BMP dhe JPEG
C) dallimi i përmbajtjeve digjitale legale dhe ilegale
D) krijimi dhe menaxhimi i blogjeve
2. “Nxënësi përcakton strategjinë e kërkimit të informacionit; duke përdorur kompjuterin gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe mediave; përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrave.” Këto rezultate të nxëni arrihen nëpërmjet zhvillimit të kompetencës së lëndës:

A) Kreativiteti dhe inovacioni
B) Kërkimi dhe gjetja e informacionit
C) Mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja
D) Operacionet bazë dhe konceptet teknologjike

B. Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë

3. Cila nga alternativat e mëposhtme përshkruan teknikën e cila bën të mundur shqyrtimin e një teme nga këndvështrime të ndryshme dhe nxënësit përshkruajnë, shoqërojnë, analizojnë, zbatojnë dhe argumentojnë kërkesa, të cilat janë në përputhje me nivelet e të nxënit.

A) Kubimi
B) Harta e koncepteve
C) Projekti kërkimor
D) Ditari dypjesësh

- 
4. Sipas taksonomisë së Bloom-it cili është niveli më ulët i domenit konjitiv të pyetjes që një mësues mund t'i drejtojë nxënësit?
- A) Të kuptuarit
 - B) Njohja
 - C) Zbatimi
 - D) Analiza
5. Arta është një mësuese e re. Ajo është e shqetësuar, pasi vëren se nxënësit nuk janë shumë të qartë nga mësimdhënia e saj. Cila nga veprimtaritë e mëposhtme do t'i sigurojë asaj të dhënat për të bërë një analizë të qartë të dobësive që paraqesin nxënësit në lëndën e saj?
- A) Diskutimi me prindërit e nxënësve.
 - B) Diskutimi me kolegët e së njëjtës lëndë.
 - C) Diskutimi me nxënësit për të kuptuar dobësitë që ato kanë.
 - D) Rezultatet e testimit të nxënësve.
6. Një teknikë veçanërisht e përshtatshme për mësimdhënie – nxënie në lëndën e TIK-ut është zgjidhja problemore, sipas studiuesve problemet shfaqen në lloje të ndryshme. Në cilat lloje problemesh nxënësit përdorin aftësitë analizuese, sintetizuese, identifikimin shkak-pasojë, vlerësimin duke kaluar nëpër të gjitha fazat e zgjidhjes së problemeve.
- A) Problemet analitike
 - B) Problemet krijuese
 - C) Problemet praktike
 - D) Problemet sintetizuese
7. Të nxënit ndërveprues është:
- A) Një qasje që synon të aktivizojë të gjitha aspektet vetjake të nxënësve (intelektin, emocionet, imagjinatën, trupin) për një të nxënë tërësor efektiv.
 - B) Proces i të nxënit që bazohet në shkëmbimin e informacionit dhe përvojave ndërmjet nxënësve dhe që pasuron të nxënin.
 - C) Proces nëpërmjet të cilit nxënësit me nivele të ndryshme arritjeje punojnë së bashku në grupe të vogla, për një qëllim të përbashkët.
 - D) Të nxënit që realizohet gjatë gjithë jetës mbi bazën e njohurive, kompetencave kyçe dhe kualifikimeve, dhe që i zhvillon ato më tej për qëllime vetjake, profesionale dhe shoqërore.

8. Bazuar në udhëzimin për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar, cila nga alternativat e mëposhtme NUK është e saktë?

- A) Për klasat 4-12 vlerësimi përfundimtar realizohet me notë, në përfundim të vitit shkollor.
- B) Nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NVv) përcaktohet duke u bazuar në tri notat e vlerësimit të vazhduar të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- C) Nota vjetore e vlerësimit me detyrë përmbledhëse (Dp) përcaktohet duke u bazuar në tri notat e vlerësimit të detyrës përmbledhëse të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- D) Nota e vlerësimit të projektit (NVp) përcaktohet në përfundim të projektit duke u bazuar në procesin e realizimit të projektit dhe në produktin përfundimtar, duke marrë në konsideratë vlerësimin me notë të bërë në secilën periudhë.


C. Aspekte të komunikimit dhe etikës

9. Mësuesi ka planifikuar një vizitë me nxënësit në bibliotekën e qytetit. Çfarë është më efektive të bëjë mësuesi, në mënyrë që edhe Joni, një fëmijë që lëviz me anë të karrocës, ta vizitojë bibliotekën?

- A) Mësuesja i kërkon një mësuesi tjetër për ta shoqëruar Jonin në këtë vizitë.
- B) Mësuesja shkon më parë në bibliotekë dhe evidenton problemet me të cilat mund të ndeshet nxënësi i saj dhe bën një planifikim paraprak.
- C) Mësuesja i kërkon Jonit të vijë i shoqëruar me një pjesëtar të familjes, i cili do ta shoqërojë atë.
- D) Mësuesja e inkurajon dhe i kërkon Jonit të qëndrojë në shtëpi ditën e vizitës.

10. Për fëmijët me aftësi të kufizuara në klasat e zakonshme, mësuesi ndihmës bën vlerësimin sipas niveleve të arritjeve të fushave të zhvillimit të përcaktuara në PEI. Ky vlerësim duhet bërë në bashkëpunim:

- A) me drejtuesin e institucionit arsimor dhe specialistë të patologjisë/ve që shfaq fëmija.
- B) me mësuesin e lëndës dhe shërbimin psiko-social të institucionit arsimor.
- C) me prindin dhe kujdestarët që kujdesen për fëmijën.
- D) me komisionin multidisiplinar të ngritur pranë ZVAP-së.



D. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

11. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) klasat 9-ta të shkollës
- B) klasat e 9 të shkollës
- C) klasat e 9-ta të shkollës
- D) klasat e 9-të të shkollës

12. Qarkoni alternativën ku fjala është shkruar saktë.

- A) Institucion arsimor
- B) Institucionë arsimorë
- C) Institucion arsimor
- D) Institucion arsimor

E. Përmbajtja shkencore e lëndës

13. Në programin Scratch, grupi i instruksioneve Events përdoret për:

- A) Të kontrolluar pamjen e skriptit
- B) Të kontrolluar lëvizjen e skriptit
- C) Të ekzekutuar fillimin e ngjarjes
- D) Të insertuar veprime matematikore

14. Si quhet sulm keqdashës kur serveri mbingarkohet me kërkesa të shumta fiktive, të cilat si pasojë sjellin rënien e pajisjes?

- A) Hashing
- B) Phishing
- C) Man in the middle
- D) Denial of Service

15. Cili është qëllimi i përdorimit të 'SmartArt' në programin Microsoft Word dhe PowerPoint?

- A) Të krijojë tabela me të dhëna të organizuara për analizë të avancuar
- B) Të krijojë grafikë dhe diagrame vizuale që ndihmojnë në paraqitjen dhe strukturimin e ideve dhe koncepteve komplekse
- C) Të ndihmojë në shpërndarjen e dokumenteve dhe prezantimeve në formate të ndryshme
- D) Të menaxhojë formatimin dhe stilizimin e tekstit në dokumente


16. Për të gjetur mesataren e vlerave numerike të qelizave të zonave A5:B10, në qelizën D2 përdoret funksioni:

- A) =AVERAGE(A5:B10)
- B) =AVG(A5:B10)
- C) =AVERAGE[A5:B10]
- D) =AVG[A5:B10]

17. Cila hapa duhet të ndiqen për të siguruar një dokument të formatit .doc me fjalëkalim?

- A) File - Info - Protect Document - Encrypt with Password
- B) File - Options- Save document with password
- C) File – General Options – Tools – Password
- D) Dokumentat e formatit .doc nuk mund të ruhen me fjalëkalim

18. Duke ekzekutuar komandën e mëposhtme në programin Scratch, çfarë veprimi supozohet të kryej figurina (sprite), pasi përdoruesi klikon mbi flamurin e gjelbër?



- A) Figurina lëviz horizontalisht majtas 50 njësi
- B) Figurina lëviz horizontalisht djathtas 50 njësi
- C) Figurina lëviz vertikalisht lartë 50 njësi
- D) Figurina lëviz vertikalisht poshtë 50 njësi


19. Cila nga alternativat e mëposhtëm përfaqëson përkufizimin e saktë në lidhje me Firewall :

- A) Është një sistem sigurie që monitoron dhe kontrollon trafikun hyrës dhe dalës të rrjetit, bazuar në disa rregulla të sigurisë.
- B) Është një sistem që siguron ndërtimin e rrjeteve virtuale private për komunikim të sigurt në internet.
- C) Është një sistem që mbron të dhënat duke enkriptuar trafikun që kalon nëpër rrjet.
- D) Është një protokoll komunikimi që rrit performancën e rrjetit përmes rishpërndarjes së burimeve të tij.

20. Cila formulë duhet të shënohet në qelizën E10 në mënyrë që të gjenerohet numri total i fletoreve të shitura në bilancin e mbajtur?

	A	B	C	D	E	F
1						
2		Produkti	Cmimi	Data	Sasia	
3		Laps	10 lekë	10/05/2023	5	
4		Fletore	25 lekë	10/05/2023	2	
5		Stilolaps	20 lekë	10/05/2023	1	
6		Fletore	25 lekë	11/05/2023	4	
7		Fletore	25 lekë	12/05/2023	5	
8		Laps	10 lekë	14/05/2023	5	
9						
10		Numri total i fletoreve të shitura:				
11						

- A) =SUMIF(E3:E8, "Fletore", B3:B8)
- B) =SUMIF(B3:B8, "Fletore", E3:E8)
- C) =SUMIF(B3:B8, E3:E8, "Fletore")
- D) =SUM(E3:E8, IF (B3:B8 = "Fletore"))



21. Si mund të vendosni një numër faqe të ndryshëm në seksione të ndryshme të dokumentit tuaj në Microsoft Word?

- A) Përdorni opsionin "Breaks" për të krijuar seksione të ndryshme dhe pastaj përdorni "Page Setup" për të vendosur numrin e faqes për çdo seksion.
- B) Përdorni opsionin "Breaks" për të krijuar seksione të ndryshme dhe pastaj përdorni "Page Numbers" për të vendosur numrat e faqes për çdo seksion.
- C) Përdorni opsionin "Margins" për të vendosur numrin e faqes për çdo seksion.
- D) Përdorni opsionin "Size" për të vendosur numrat e faqes në çdo seksion.

22. Të përcaktohet renditja e saktë e komponentëve të sistemit kompjuterik, mbështetur në shpejtësinë e transmetimit të të dhënave dhe duke filluar nga më e shpejta:

- A) Cache, RAM, Hard Disk,
- B) Cache, Hard Disk, RAM
- C) RAM, Cache, Hard Disk
- D) Hard Disk, RAM, Cache

Model pyetjesh të lëndës teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK) - Arsimi i Mesëm i Lartë

A. Programi lëndor

1. Në cilën prej tematikave të mëposhtme nxënësit zhvillojnë njohuri lidhur me përzgjedhjen e strukturave të të dhënave për zgjidhjen e problemeve të ndryshme.
 - A) Programimi në web
 - B) Programimi dhe algoritmika
 - C) Përpunimi digjital i të dhënave
 - D) JAVA
2. Cilën kompetencë lëndore zhvillon dhe mat rezultati i të nxënësit “Nxënësit punojnë me një komunitet online për të arritur një qëllim të përbashkët kërkimor duke marrë parasysh përgjegjësinë për të integruar të gjithë anëtarët e komunitetit”
 - A) Komunikimi me TIK
 - B) Hetimi me TIK
 - C) Menaxhimi dhe operimi me TIK
 - D) Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK-un.

B. Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë

3. Cili nga pohimet e mëposhtëm nuk është i vërtetë në lidhje me testin/detyrën përmbledhëse:
 - A) Mësuesi duhet të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor testet ose detyrat përmbledhëse.
 - B) Koha e realizimit të testit ose detyrës përmbledhëse është 45 minuta.
 - C) Testi/detyra përmbledhëse domosdoshmërisht realizohet në fund të periudhës.
 - D) Në momentin kur mësuesi vlerëson testet/detyrat përmbledhëse, i vendos notat në regjistër.

4. Teknika _____ është një teknikë, e cila u kërkon nxënësve të mendojnë rreth një çështjeje dhe të diskutojnë rreth saj me synim ndërtimin e njohurive të reja. Kjo teknikë siguron një mjedis të lirë dhe të hapur, që inkurajon të gjithë pjesëmarrësit për të shprehur në mënyrë kreative mendimet e tyre rreth një problemi.

- A) Brainstorming
- B) Harta e koncepteve
- C) Projekti kërkimor
- D) Debati

5. Strategjitë, metodat dhe teknikat mësimore janë:


- A) një grup sjelljesh dhe qëndrimesh që ndikojnë në mënyrën se si nxënësit mësojnë dhe bashkëveprojnë me mësuesit dhe me shokët e tyre;
- B) procedura standarde didaktike, të cilat përdoren nga ana e mësuesve në bashkëpunim me nxënësit, për prezantimin dhe zhvillimin e veprimtarive mësimore, me qëllim përmbushjen e rezultateve të të nxënit;
- C) situata dhe procese jetësore që sigurojnë kushtet dhe mjedisin për nxitjen e të mësuarit tek nxënësit;
- D) veprimtari të strukturuar mësimore, të qëllimshme që ndodhin jashtë kontekstit të lëndëve dhe fushave të të nxënit.

6. Duke kontrolluar punën që po zhvillojnë nxënësit në klasë mësuesi vë re se njëri prej nxënësve e ka zgjidhur ushtrimin në mënyrë të gabuar. Hapi i parë që mësuesi duhet të ndërmarrë për të përmirësuar këtë mangësi është:

- A) I jep ushtrime të ngjashme për detyrë shtëpie
- B) Bashkëbisedon me nxënësin dhe ndihmon për gjetjen e gabimit
- C) I thotë nxënësit ta zgjidhë edhe njëherë ushtrimin
- D) I tregon vetëm përgjigjen e saktë të ushtrimit

7. Metoda “Di-Dua të Di-Mësova” i ndihmon më shumë nxënësit:

- A) të përzgjedhë një temë aktuale, të përcaktojë qartë të gjitha çështjet për të cilin do të hulumtohet, të përcaktojë produktet finale të projektit si dhe të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit.

- 
- B) të aktivizojnë atë që dinë më parë, të bëjnë parashikime mbi atë që do të lexojnë, nëpërmjet pyetjeve që dalin, si dhe të organizojnë atë çfarë kanë mësuar pasi të kenë mbaruar leximin.
- C) të krahasojnë një sërë konceptesh/termash të rëndësishme me cilësi të ndryshme duke nxjerrë të përbashkëtat dhe dallimet mes koncepteve të ndryshme të TIK-ut.
- D) të tregojnë nëpërmjet rubrikës komente qëndrimin dhe vlerësimin e tyre për një ngjashmëritë midis dy koncepteve.
8. Një mësues dëshiron të prezantojë konceptet e sigurisë në internet për nxënësit. Cila metodë më e avancuar pedagogjike do t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë implikimet praktike të sigurisë në internet?
- A) Të krijojë një skenar interaktiv dhe simulues ku nxënësit luajnë rolin e administratorëve të rrjeteve dhe janë përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave të tyre përballë sulmeve të mundshme.
- B) Të ofrojë një prezantim të detajuar dhe teknik mbi protokollet dhe mekanizmat e sigurisë në internet.
- C) Të kërkojë nga nxënësit të hartojnë një ese që eksploron rëndësinë e masave të sigurisë në internet në jetën e përditshme.
- D) Të përdorë materiale vizuale të përgatitura paraprakisht që shpjegojnë konceptet e sigurisë në internet, pa përfshirje të drejtpërdrejtë të nxënësve në diskutime apo aktivitete.

C. Aspekte të komunikimit dhe etikës

9. Në një klasë ku ka nxënës me vështirësi në të nxënë, mësuesi:
- A) vendos të njëjtat rezultate të nxëni për të gjithë nxënësit e klasës, por realizon punë tëdiferencuar me nxënës të ndryshëm;
- B) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel më të ulët arritjesh;
- C) vendos rezultate të nxëni të ndryshme për nxënës të ndryshëm;
- D) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel të lartë arritjesh.

10. Procesi i gjithëpërfshirjes fillon me:

- A) nxitjen e diferencave mes nxënësve.
- B) njohjen dhe pranimin e diferencave mes nxënësve.
- C) zhvillimin e të drejtave të nxënësve.
- D) thellimin e diferencave mes nxënësve.

D. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

11. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) Procedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të ministrit.
- B) Proçedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të ministrit.
- C) Procedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të Ministrit.
- D) Proçedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me Udhëzim të Ministrit

12. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) Portofoli profesional i mësuesit
- B) Portofoli profesjonal i mësuesit
- C) Portofoli profesional i mësuesit
- D) Portofoli profesijonal i mësuesit

E. Përmbajtja shkencore e lëndës

13. Instruksioni që lejon ndryshimin e rregullt të fluksit të instruksioneve, i cili provokon daljen e menjëhershme nga cikli për të vazhduar me instruksionin që pason ciklin quhet:

- A) Instruksioni break
- B) Instruksioni continue
- C) Instruksioni switch
- D) Instruksioni for each

14. Cili nga komponentët e mëposhtëm bën të mundur përkthimin e kodit burim në një kod ndërmjetës dhe interpreton këtë kod rresht pas rreshti?

- A) Kompilatori
- B) Asembleri
- C) Interpretuesi
- D) Përpiluesi

15. Qëllimi i atributit "alt" i një elementi "img" në HTML është të:

- A) specifikojë tekstin që përdouesi duhet të klikojë për të shfaqur një imazh
- B) specifikojë tekstin që duhet të shfaqet kur mausi vendoset sipër një imazhi
- C) specifikojë vendodhjen e imazhit në internet
- D) specifikojë tekstin që duhet të shfaqet nëse imazhi nuk ngarkohet

16. Kush është instruksioni i saktë që duhet ekzekutuar në SQL, për të selektuar të gjithë emrat që fillojnë me shkronjën "B" në kolonën Emri_Studenti të tabelës STUDENT?

- A) SELECT * FROM STUDENT WHERE Emri_Studenti LIKE 'B%'
- B) SELECT * FROM STUDENT WHERE Emri_Studenti LIKE '%B'
- C) SELECT * FROM STUDENT WHERE Emri_Studenti ='B'
- D) SELECT * FROM STUDENT WHERE Emri_Studenti ='%B%'

17. Çfarë do të afishohet në konsolë nëse ekzekutojmë kodin e mëposhtëm në JavaScript:

```
var vektori=[8, 10, 12];
```

```
console.log(vektori[3]);
```

- A) 12
- B) 8 10 12
- C) undefined
- D) 12 12 12

18. Bazuar në funksionet e shtresave së modelit TCP/IP, cila shtresë (layer) është përgjegjëse për ndarjen e të dhënave në paketa të njohura si datagrame IP, të cilat mbartin adresën e burimit dhe destinacionit?

- A) Shtresa e link-ut
- B) Shtresa e rrjetit
- C) Shtresa e transportit
- D) Shtresa e aplikacionit

19. Instruksioni Scanner s=new Scanner (System.in) në gjuhën Java përdoret:

- A) Për të deklaruar dhe iniciuar një objekt, i cili do të përdoret për të afishuar rezultatet e gjeneruara pas ekzekutimit të programit.
- B) Për të deklaruar dhe iniciuar një objekt, i cili do të përdoret për të marrë të dhëna e insertuara nga ana e përdoruesi.
- C) Për të deklaruar dhe iniciuar një funksion, i cila do të përdoret për të afishuar rezultatet e gjeneruara pas ekzekutimit të programit.
- D) Për të deklaruar dhe iniciuar një klasë, e cila do të përdoret për të marrë të dhëna e insertuara nga ana e përdoruesi.

20. Çfarë do të shfaqet në ekran pas ekzekutimit të kodit të mëposhtëm në gjuhën C++?

main.cpp

```
1  #include <iostream>
2  using namespace std;
3  int main()
4  { for (int i = 0; i < 10; i++)
5  { if (i % 2 == 0)
6  { continue; }
7    cout << i <<" "; }
8    return 0;
9  }
10
```

- A) 1 3 5 7 9
- B) 2 4 6 8 10
- C) 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10
- D) Error

21. Përzgjidhni pohimin e saktë.

- A) Në ndryshim nga enkriptimi simetrik, i cili përdor një çelës të vetëm për inkriptimin dhe dekriptimin e mesazhit, enkriptimi asimetrik përdor dy çelësa të ndryshëm.
- B) Në ndryshim nga enkriptimi asimetrik, i cili përdor një çelës të vetëm për inkriptimin dhe dekriptimin e mesazhit, enkriptimi simetrik përdor dy çelësa të ndryshëm.
- C) Enkriptimi asimetrik është matematikisht më i thjeshtë dhe më i shpejtë sesa enkriptimi simetrik, për këtë arsye është më i përdorshëm në rastet kur dëshirojmë të krijojmë materiale me shumë kapacitet magazinimi.
- D) Në enkriptimin simetrik përdoren dy çifte çelësash, të emërtuar si çelës publik dhe çelës privat, të cilët bëjnë të mundur inkriptimin dhe dekriptimin e mesazhit.**

22. Cfarë do të shfaqet në web-browser pas ekzekutimi të kodit të mëposhtëm në JavaScript?

```
<script>
```

```
var punonjës = {emri:"Megi", pozicioni:"programues", paga:500};
```

```
var punonjës1 = {emri:"Gebri", pozicioni:"data-analist", paga:800};
```

```
document.writeln ("Të dhëna: " + punonjës.emri + " "+ punonjës1.paga);
```

```
</script>
```

- A) Të dhëna: Megi 800**
- B) Të dhëna: Megi 500
- C) Të dhëna: Gebri 800
- D) Të dhëna: Gebri 500

Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, përsa i përket mënyrës sesi ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënësve dhe përshtaten me stilet e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve. Një mësimdhënie - nxënie e mirëmenduar dhe e mirëplanifikuar, si dhe një mjedis të nxënësve efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtim ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Më poshtë janë paraqitur tre modele orësh mësimore për lëndën e TIK-ut në nivelet arsimore *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML

Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënës, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.

Model ore mësimore në lëndën e TIK-ut AMU

Fusha: TEKNOLOGJI DHE TIK	Lënda: TIK	Shkalla: 3	Klasa: VII																
Tematika: Përpunimi digjital i tekstit		Situata e të nxënit:																	
Tema mësimore: Analiza e të dhënave dhe përdorimi i formulave në Excel .		▪ Kujtoni veprimet e organizuara për një qelizë në Excel. Si do të veprojmë me veprime më të komplikuar? ▪ Duke marrë shkas nga njohuritë që keni marrë në lëndën e matematikës, gjeni notën mesatare të marrë në një grup prej 10 nxënësish , tabela e dendurive për të cilët është dhënë më poshtë: <table><tr><td>nota</td><td>4</td><td>5</td><td>6</td><td>7</td><td>8</td><td>9</td><td>10</td></tr><tr><td>denduria</td><td>2</td><td>3</td><td>2</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>2</td></tr></table> Si mendoni, a mund ta gjejmë këtë me anë të Excel-it?		nota	4	5	6	7	8	9	10	denduria	2	3	2	0	1	0	2
nota	4	5	6	7	8	9	10												
denduria	2	3	2	0	1	0	2												
Rezultatet e të nxënit të kompetencave digjitale sipas temës mësimore: <i>Nxënësi:</i> ▪ kopjon një formulë të thjeshtë të dhënë gati në tabelë; ▪ shkruan një formulë me jo më shumë se dy veprime;		Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të nxënit: Nxënësi përzgjedh me efikasitet të dhëna nga burime të ndryshme dhe i shfrytëzon për të arritur realizimin e temës mësimore;																	


▪ shkruan formulën më qëllim llogaritjen e përmbajtjes së saj; ▪ lexon gabimet që mund të dalin gjatë llogaritjes së qelizave në Excel; ▪ përshtat një situatë problemore në një tabelë të specifikuar për zgjidhjen e saj.	Kompetenca e të menduarit: Nxënësi organizon lidhjen konceptuale të njohurive; Kompetenca personale: Nxënësi demonstroi pavarësi në mendime e veprime; Kompetenca qytetare: Nxënësi përkushtohet ndaj rregullave të mirësjelljes dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave që i thyejnë ato.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi; ...etj.	<u>Burimet:</u> Libri i nxënësit; videoprojektor; laboratori i TIK-ut; laptop; tableta, etj.	<u>Fjalët kyçe:</u> Qelizë, barazim, kllapa, enter, sum, average; radhë veprimesh; Microsoft Excel; Formulas; Function, Auditing, Error Checking, etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve		

Organizimi i orës së mësimi:

Faza 1:

Parashikimi i të nxënësve - diskutim për njohuritë paraprake + drejtim i imagjinatës – punë me klasën- 5 min:

Fillohet biseda duke i njohur nxënësit fillimisht me temën dhe drejtohet imagjinata e tyre në njohuritë e marra në klasën e gjashtë mbi mundësitë e shumta që na ofron përdorimi i programit Microsoft Excel. Këtu natyrisht përdoren pauza në bisedim të cilat u japin “ftesën” e pjesëmarrjes në diskutim. Në qos ata ngurojnë, artikulojnë me ngadalë veprimet matematikore, si psh: mbledhja, zbritja, shumëzimi, pjesëtimi etj, duke zgjuar kujtesën e tyre. Këtu mund t’u kërkojmë nxënësve të tregojnë në faqen e hapur të Excel-it, tek menuja “Home”, vendndodhjen e komandave, të cilat realizojnë kryerjen e veprimeve të ndryshme matematikore.



Jepet pjesa e dytë e përshkruar në situatë, një ushtrim matematikor i njohur prej tyre dhe pritët të realizojnë zgjidhjen. I japim formën përfundimtare bashkarisht këtij ushtrimi në tabelën e zezë.

$$(Nm = \frac{2x4 + 3x5 + 2x6 + 0x7 + 1x8 + 0x9 + 2x10}{10} = \frac{63}{10} \approx 6,3)$$

dhe më pas identifikojmë këtu “nevojën” apo mundësitë që na jep Excel-i.

Faza 2:

Ndërtimi i njohurive të reja-vëzhgo- analizo-diskuto + kategorizimi i problemit - punë në grupe + punë me klasën - 30 min:

Gjithsesi, realizohet duke selektuar “qelizën rezultat” dhe duke e tërhequr “kursorin” e shfaqur në cepin e djathtë -poshtë të saj, deri në pozicionin e nevojshëm.

Këtu lihen pak të lirë të provojnë saktësinë e kësaj mënyre, psh duke plotësuar disa prej qelizave të mëposhtme të kollonave B, C e D.

Më pas, u kërkohet të realizojnë, secili prej grupeve, një llogaritje me dy veprime, njëri prej të cilëve të jetë shumëzim apo pjesëtim dhe tjetri mbledhje apo zbritje. Këtu gjejmë vend për të kujtuar radhën e veprimeve në shprehjet numerike në matematikë dhe ta paralelizojmë atë me veprimet që na mundëson Excel-i, duke përfshirë edhe kllapat.

Lexohet materiali në pjesën “Gabimet gjatë llogaritjes së një formule në Excel”.

Përsëri me mundësitë që ofron përdorimi i videoprojektorit, shpjegohet se te shiriti i menuve dhe komandave në Excel, ndodhet menuja “*Formulas*”, e cila është specifike vetëm për këtë program, ku mund të krijojmë formula dhe funksione për llogaritjen e të dhënave, si dhe të bëjmë korrigjimet e mundshme. Po kështu, mund të shohim edhe shfaqjen e mesazheve të gabimit dhe shkaqet e mundshme. Shfaqet për nxënësit tabela e mëposhtme për të treguar disa prej mesazheve të gabimeve që ndodhin më shpesh gjatë punës në Excel.

Mesazhet e gabimit	Shkaqet e mundshme
#####	Kolona nuk është e gjerë mjaftueshëm për të paraqitur rezultatin ose vlerën.
#DIV/0!	Është bërë pjesëtimi me zero, që është i palejueshëm në matematikë.
#N/A	Të dhënat janë të padisponueshme, psh mund të mungojnë nëpër qeliza. Apo qeliza mund të jetë bosh.
#VALUE!	Të dhënat janë të pavlefshme, psh mbledh një numër me një string.
#NAME!	Teksti nuk njihet nga programi.
#REF!	Referenca e qelizës është e pavlefshme.


Faza 3:

Hapi i parë:

Shpenzimet javore për disa artikuj në familjen time											
Ditët	bukë	lekë	ujë	lekë	perime	lekë	fruta	lekë	bulmet	lekë	totali (lekë)
e hënë	1	120	2	220	3kg	580	5kg	870	4kg	230	=E8+G8+I8+K8+M8
e martë											
e mërkurë											
e enjte											
e premte											
e shtunë											
e diel											
Totali javor											

Hapi i dytë:

Shpenzimet javore për disa artikuj në familjen time											
Ditët	bukë	lekë	ujë	lekë	perime	lekë	fruta	lekë	bulmet	lekë	totali (lekë)
e hënë	1	120	2	220	3kg	580	5kg	870	4kg	230	2020
e martë											0
e mërkurë											0
e enjte											0
e premte											0
e shtunë											0
e diel											0
Totali javor											



- Grupit të dytë i jepet si detyrë që të realizojnë një studim formulash të disa figurave matematikor, duke hartuar më parë një tabelë përmblledhëse dhe më pas duke zbatuar ato veprime që u ka mësuar.

Materialin mund ta printojnë apo edhe ta dërgojnë më pas me e-mail


U jepet si shembull tabela e mëposhtme dhe hapat në të sipas pamjeve të mëposhtme:

Hapi i parë

	a	b	h	Syprina(cm ²)
Katrori	2	2		$=E7 * F7$
Drejtëndëshi				
Trapezi				
trekëndëshi				



a = 2 cm




a = 4 cm

b = 2 cm



a = 3 cm

h = 4 cm



b = 3,2 cm

a = 5 cm


h = 3,5 cm

Hapi i dytë:

	a	b	h	Syprina(cm ²)
Katrori	2	2		4
Drejtëndëshi	4	2		8
Trapezi	5	3,2	3,5	10,85
trekëndëshi	3		4	$=(E10 * G10) / 2$



a = 2 cm




a = 4 cm

b = 2 cm



a = 3 cm

h = 4 cm



b = 3,2 cm

a = 5 cm


h = 3,5 cm

Hapi i tretë:

	a	b	h	Syprina(cm ²)
Katrori	2	2		4
Drejtëndëshi	4	2		8
Trapezi	5	3,2	3,5	10,85
trekëndëshi	3		4	6
Syprina e figurës së përbërë				18



a = 2 cm




a = 4 cm

b = 2 cm



a = 3 cm


h = 4 cm



b = 3,2 cm


a = 5 cm

h = 3,5 cm



Vlerësimi sipas niveleve:

N2: nxënësi kopjon veprimin e kërkuar sipas formulës së përcaktuar me një veprim;



kryen kopjimin e formulës në një grup qelizash;

N3: nxënësi dallon dhe përshkruan zbatimin e formulave me dy veprime sipas specifikimeve;

zgjidh kërkesa të ndryshme duke radhitur veprimet sipas rregullave të mësuara;

N4: nxënësi argumenton gabimet që mund të dalin gjatë punës me formulat në Excel;

përshtat një situatë problemore sipas mësimit, duke u nisur që në planifikim, zbatim dhe deri në specifikimin e saktë të zgjidhjes së saj.

Model ore mësimore në lëndën e TIK-ut AML

Fusha: TEKNOLOGJI DHE TIK	Lënda: TIK	Shkalla: 5	Klasa: X
Tematika: Programimi në Web		Situata e të nxënit:	
Tema mësimore: HTML dhe CSS		Stilizimi i elementeve HTML ndërmjet përdorimit të gjuhës CSS në tri mënyra të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit sipas temës mësimore:			
<i>Nxënësi:</i> - njih rolin e përdorimit të gjuhës CSS në faqet e internetit (website) - identifikon mënyrat e inkorporimit të elementeve CSS në dokumentet HTML - aplikon njohuritë e marra në stilizimin praktik të elementeve HTML			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Mateamatikë, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi; ...etj.		<u>Burimet:</u> Libri i nxënësit; videoprojektor; laborator i TIK-ut; laptop; tableta, program Notepad++	<u>Fjalët kyçe:</u> HyperText Markup Language (HTML), Cascading Style Sheets (CSS), sintaksë, stilizim, skedarë, paragrafë, imazh, link.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit:			
<i>Parashikimi (Diskutim për njohuritë paraprake)</i>			
Mësuesi u drejton nxënësve pyetje të shkurtra që kanë lidhje me temën e mësimit të ri:			
- Si mendoni ju se si realizohet stilizimi i faqeve të internetit? - Cilat janë elementet grafike që ju tërheqin më shumë vëmendjen kur jeni duke naviguar në një faqe interenti? - Sa të familjarizuar jeni ju me gjuhën CSS?			


- Cili mendoni se është roli i përdorimit të kësaj gjuhe në dokumentat HTML?

Nxënësit japin përgjigjet e tyre lidhur me pyetjet e mësipërme. Ata komentojnë përgjigjet e shokëve/shoqeve dhe shtojnë ide të reja. Mendimet më të sakta mesuesi mund ti shkruajë në flipçart ose në dërrasën e zezë.

Pasi ka ftuar nxënësit në diskutim dhe ka marrë një feedback lidhur me njohuritë aktuale që nxënësit zotërojnë rreth gjuhës CSS, mësuesi shkruan në tabelë ose në flipchart **HTML + CSS** dhe nxit nxënësit të japin përgjigje lidhur me funksionin e përdorimit të këtyre gjuhëve duke marrë në konsideratë të përbashktat dhe dallimet që mund të kenë këto dy gjuhë.



Në përfundim të diskutimit paraprak me nxënësit, mësuesi paraqet në videoprojektor imazhin e mëposhtëm, i cili paralelizon përdorimin e gjuhës HTML dhe CSS me situatë nga jeta e përditshme, për të kuptuar më qartë arsyen e përdorimit të kodit CSS në dokumentat



HTML.

Ndërtimi i njohurive:

Mësuesi shpjegon në terma teorik funksionimin e përdorimit të gjuhës CSS, së bashku me mënyrat e inkoorporimit dhe përfshirjes të elementeve CSS në dokumentet HTML.

Mënyrat e përfshirjes së kodeve CSS në një file **.html**

- a) Inline (në një rresh) duke përdorur atributin style brenda elementi HTML
- b) Internal (e brendshme) duke përdorur tagun <style> </style> në seksionin e head-it
- c) External (e jashtme) duke përdorur një file CSS të jashtëm

Mësuesi i fton nxënësit të hapin programin Notepad++ ose një editor online dhe të krijojnë strukturën e një dokumenti HTML. Për nxënësit, të cilët paraqesin vështirësi në krijimin e strukturës së dokumentit HTML, mësuesi i inkurajonë këta nxënës të ndjekin paralelisht punën që ai/ajo po shfaq në video-projektor.

Pasi nxënësit kanë krijuar strukturën e dokumentit, mësuesi i thotë nxënësve që në dokumentin e ruajtur (save) me prapashtesën **.html** të shtojnë disa elemente të njohura për ta siç mund të jenë: paragrafët, headings, imazhet, linqet etj...

Nxënësit ndahen në grupe dhe përcaktohen detyrat për secilin grup:

Grupi I: Të realizojë stilizimin e elementeve HTML duke përdorur stilizimin inline

Grupi II: Të realizojë stilizimin e elementeve HTML duke përdorur stilizimin internal

Grupi III: Të realizojë stilizimin e elementeve HTML duke përdorur stilizimin external, me ndihmën e një skedari të jashtëm të pavarur të ruajtur me prapashtesën **.css**

Mësuesi përcakton formatin e stilizimit për secilin nga elementet HTML

<body> </body> sfondi i background-it duhet të jetë ngjyrë kafe

`<p> </p>` teksti i shkruajtur brenda paragrafit duhet të jetë i llojit “Helvetica” dhe me ngjyrë të bardhë.

`<h1> </h1>` teksti i shënuar brenda headings duhet të jetë i nënvizuar dhe me ngjyrë të verdhë.

`<img>` imazhet duhet të përmbajnë një kornizim 5 px me ngjyrë të zezë.

Ndërkohë që nxënësit punojnë në çifte për realizimin e kësaj detyre, mësuesi kalon nëpër kompjuterat e nxënësve për të parë ecurinë e punës, për të kontrolluar nivelin e përvetësimit të njohurive të marra, si dhe për të dhënë ndonjë ndihmë lidhur me pyetjet, paqartësitë apo vështirësitë që nxënësit hasin.

Pasi nxënësit kanë mbaruar me shkrimin e kodit, mësuesi fton para klasës një çift përfaqësuesish nga secili grup për të ekzekutuar kodin në kompjuterin e lidhur me video projektorin.

- *Stilizimi inline*

```
<!DOCTYPE html>
<html>
<head>
<title>Page Title</title>

</head>
<body style="background:brown;">
<h1 style="color:yellow; text-decoration: underline; ">Historia e Skënderbeut</h1>
<p style="color:white; font-family: Helvetica;">Gjergj Kastrioti ka hyrë në histori nga gjeneralët më të mëdhenj të kohës, si një strateg i shquar i luftimeve mbrojtëse, sepse me një ushtri të vogël mundi të përballonte dhe të shkatërronte taborret ushtrisë osmane, më të organizuarat dhe më modernet e kohës së vet. Me Kuvendin Lezhës më Skënderbeu vuri themelet e një shteti arbër të organizuar – as para tij princat shqiptarë nuk mundën të gjenin rrugën e bashkimit.</p>

</body>
</html>
```

Historia e Skënderbeut

Gjergj Kastrioti ka hyrë në histori si një nga gjeneralët më të mëdhenj të kohës, si një strateg i shquar i luftimeve mbrojtëse, sepse me një ushtri të vogël mundi të përballonte dhe të shkatërronte taborret e ushtrisë osmane, më të organizuarat dhe më modernet e kohës së vet. Me Kuvendin e Lezhës më Skënderbeu vuri themelet e një shteti arbër të organizuar – as para tij as pas tij princat shqiptarë nuk mundën të gjenin rrugën e bashkimit.



Historia e Skënderbeut

Gjergj Kastrioti ka hyrë në histori si një nga gjeneralët më të mëdhenj të kohës, si një strateg i shquar i luftimeve mbrojtëse, sepse me një ushtri të vogël mundi të përballonte dhe të shkatërronte taborret e ushtrisë osmane, më të organizuarat dhe më modernet e kohës së vet. Me Kuvendin e Lezhës më Skënderbeu vuri themelet e një shteti arbër të organizuar – as para tij as pas tij princat shqiptarë nuk mundën të gjenin rrugën e bashkimit.



- ***Stilizimi internal***

```
<!DOCTYPE html>
<html>
<head>
<title>Page Title</title>
<style>
body {
  background-color: brown;}
h1 {
  color: yellow;
  text-decoration: underline;}
p{
  color:white; font-family: Helvetica;}
img
{border:5px solid black;
}
</style>
</head>
<body>
<h1>Historia e Skënderbeut</h1>
<p>Gjergj Kastrioti ka hyrë në histori si një nga gjeneralët më të mëdhenj të kohës, si një strateg i shquar i luftimeve mbrojtëse, sepse me një ushtri të vogël mundi të përballonte dhe të shkatërronte taborret e ushtrisë osmane, më të organizuarat dhe më modernet e kohës së vet. Me Kuvendin e Lezhës më Skënderbeu vuri themelet e një shteti arbër të organizuar – as para tij as pas tij princat shqiptarë nuk mundën të gjenin rrugën e bashkimit.</p>

</body>
</html>
```


- ***Stilizimi external***

Historia e Skënderbeut

Gjergj Kastrioti ka hyrë në histori si një nga gjeneralët më të mëdhenj të kohës, si një strateg i shquar i luftimeve mbrojtëse, sepse me një ushtri të vogël mundi të përballonte dhe të shkatërronte taborret e ushtrisë osmane, më të organizuarat dhe më modernet e kohës së vet. Me Kuvendin e Lezhës më Skënderbeu vuri themelet e një shteti arbër të organizuar – as para tij as pas tij princat shqiptarë nuk mundën të gjenin rrugën e bashkimit.



```
body {
  background-color: brown;}
h1 {
  color: yellow;
  text-decoration: underline;}
p{
color:white; font-family: Helvetica;}
img
{border:5px solid black;
}
```



Mësuesi fton nxënësit të japin komente lidhur me mënyrën më efektive të përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML, si dhe të japin një vlerësim lidhur me punën e realizuar nga grupet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Për vlerësimin e nxënësve do të përdoren: përgjigjet me gojë, vëzhgime të drejtëpërdrejta gjatë punës në çift dhe individuale.

Nxënësi vlerësohet për:

- Identifikimin e tri mënyrave të përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML
- Stilizimin e elementeve HTML duke përdorur gjuhën CSS
- Aplikimin e njohurive të marra duke krijuar faqe të thjeshta html me elementë të ndryshëm stilizimi.
- Përdorimin e fjalorit informatik
- Bashkëpunimin përgjatë punës në grup

Vlerësimi bazuar në nivelet e arritjeve:

Niveli 2: Identifikon mënyrat e përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML

Niveli 3: Përdor disa prej mënyrave të përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML për të stilizuar elementë të thjeshtë që mund të përmbajë një faqe interneti.

Niveli 4: Vlerëson rendësinë e përfshirjes së kodit CSS brenda një dokumenti HTML duke argumentuar rreth përzgjedhjes së mënyrave më efektive.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësve i'u kërkohet të krijojnë një faqe web-i për një biznes lokal, ku të vendosen të gjithë elementet (taget) HTML të mësuara deri më tani dhe për elementë të ndryshëm të përdoren tri metodat e përfshirjes së kodit CSS. Detyra do të sillet e printuar dhe skedarët .html dhe .css të jenë të ruajtur në një USB për të parë ekzekutimin në klasë.

Orientime për zhvillimin e orës mësimore të hapur

A. Planifikimi i orës mësimore të hapur

Mësuesi planifikon të gjithë **komponentët e orës së mësimi** në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënit:

- planifikon *rezultatet e të nxënit sipas programit lëndor;*
- planifikon *situatë të nxëni të cilën e përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies;*
- planifikon *organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënit;*
- planifikon *pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.*

Mësuesi planifikon temën mësimore me **qasje të reja inovative** që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore:

- planifikon *qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor;*
- planifikon *të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.*

B. Mjedis i të nxënit

Mësuesi krijon një **klimë pozitive dhe mjedis miqësor**, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri -tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe:

- promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe;

- krijon një kulturë të nxëni për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.

Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes:

- *organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me **detyra motivuese** dhe i nxit ata të ndërmarrin iniciativa.*
- *nxit nxënësit **të shprehin mendimet e tyre**, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.*

C. Metodatat mësimore

Mësuesi organizon nxënësit në varësi të metodave dhe stileve të të nxënësit:

- *përdor metoda e teknika që i lidh më së miri me stilet e të nxënësit;*
- *përdor metoda e teknika duke i dhënë mundësi nxënësit të përmirësojnë arritjet e tij.*

Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin):

- *përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik, krijues të nxënësit;*
- *përdor metoda dhe teknika që nxisin diskutimin dhe i jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në veprimtari.*


Mësuesi formulon pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme duke nxitur nxënësit të bëjnë pyetje përgjatë orës së mësimit:

- *Mësuesi ndërton pyetje sipas niveleve;*
- *Nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit duke iu drejtuar dhe njëri – tjetrit.*

D. Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve

Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij:

- *përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit;*

- 
- *përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit.*

Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes:

- *përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.*

Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësit dhe nevojave të nxënësve:

- *Angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësit dhe nevojave të tyre.*

E. Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale

Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore:

- *krijon mjete mësimore didaktike në përmbushje të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore;*
- *nxit te nxënësit të mësuarin praktik dhe krijues.*

Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve:

- *përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut;*
- *përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.*

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore:

- mbështesin mësuesit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë, si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore për të gjykuar dhe për të vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore.

Zhvillimi i orës mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet dhe sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore				
Gjithsej 30 pikë				
Përshkruesit	Niveli 1 - Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
Planifikimi i orës mësimore të hapur (6 pikë)				
	0 pikë	1 pikë	2 pikë	3 pikë
Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të nxënësve.	Nuk ka një koherencë mes komponentëve të orës mësimore. Rezultatet e të nxënësve (RN) nuk bazohen në programin lëndor. Metodologjia është	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënësve, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e rezultateve të të nxënësve (RN) ose	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënësve, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodot dhe	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënësve, cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e

	tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënësve. Pyetjet që janë planifikuar nuk janë të llojeve dhe të niveleve të ndryshme.	nuk ka planifikuar situatë të nxënësve. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxënësve. Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.	teknikat mësimore janë në koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënësve dhe me stilet e të nxënësve. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.	nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënësve, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.
Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënësve gjatë gjithë jetës, përveç kompetencave lëndore.	Mësuesi nuk planifikon duke përfshirë qasje të reja inovative dhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.	Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.	Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke	Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe

			<i>lënë mënjane kompetencat kyç të të nxënës gjatë gjithë jetës.</i>	<i>rezultate të kompetencave kyç të të nxënës gjatë gjithë jetës.</i>
Mjedisi i të nxënës (6 pikë)				
Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri -tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.	<i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, por jo të gjithë nxënësit kanë komunikim me mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimit vetëm disa nxënës përfaqësohen në veprimtaritë e orës së mësimit për të shprehur mendimet e tyre.</i>	<i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënës, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënës, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënës për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i>
Mësuesi angazhon dhe përfaqësojnë të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfaqësohen.</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku jo të gjithë nxënësit përfaqësohen dhe</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfaqësohen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfaqësohen dhe angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të</i>

iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.	<i>Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve marrin një lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimi.</i>	<i>angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve marrin një përgjigje.</i>	<i>detyra motivuese duke i lënë disi pasivë. Ai u kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve marrin një përgjigje.</i>	<i>ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>
--	--	---	--	---

Metodat mësimore (6 pikë)

Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, dhe krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin), si dhe mendimin ndryshe.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u përqendruar më së shumti vetëm te ato tradicionale.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimi, duke u përqendruar më së shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxitin mendimin kritik dhe krijues të nxënësit, por vetëm disa</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumë llojshmëri të metodave të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, ai përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik dhe krijues të nxënësit, që nxisin</i>
---	--	---	---	--

	<i>Gjatë zhvillimit të orës mësimore, mësimi përqendrohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i>	<i>mësimore, vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i>	<i>nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i>	<i>diskutimin (apo debatin) dhe u jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i>
Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësim.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe llojeve të niveleve të ndryshme. Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësim por nuk u jep mundësi</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësim, por nuk u jep mundësi</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësim.</i>

	<i>nxënësit të bëjnë pyetje..</i>	<i>nxënësve të përgjigjen vetë.</i>		
Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (6 pikë)				
Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes.	<i>Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimit. Mësuesi përdor disa teknika vlerësimi, por nuk përdor nivelet e arritjes për të vlerësuar përmbushjen e rezultateve të të nxënësve të orës mësimore.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi e përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit. Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënësve të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Ai përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit, duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënësve nga</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Ai përdor vlerësimin për të identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga</i>

			<i>mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>nxënësit, sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënit të orës mësimore.</i>
Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënit dhe nevojave të nxënësve.	<i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënit apo nevojat e nxënësve.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, por angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara, duke u bazuar në nevojat e tyre.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënit dhe nevojave të tyre.</i>
Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (6 pikë)				
Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	<i>Mësuesi nuk përdor mjetet mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore, por nuk i angazhon shumë nxënësit në përdorimin e tyre.</i>	<i>Mësuesi ka krijuar mjetet mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxisë te ata të</i>

				<i>mësuarin praktik dhe krijues.</i>
Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.	<i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore,</i>	<i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale, por ato nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore, por nxënësve nuk angazhohen në përdorimin e TIK-ut.</i>	<i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësve në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>

Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular


Projektet kurrikulare kërkojnë që nxënësit të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin mësimor. Ata bëhen nxënës aktivë që marrin pronësinë e arsimit të tyre, kryejnë kërkime, analizojnë të dhënat dhe zbatojnë njohuritë e tyre në situata të botës reale. Nxënësit mund të shohin rëndësinë dhe praktikitetin e asaj që po mësojnë ndërsa trajtojnë problemet nga jeta praktike, eksplorojnë tema me interes personal ose adresojnë çështje të komunitetit.

Projektet kurrikulare përfshijnë integrimin e njohurive dhe aftësive nga fusha të shumta lëndore, duke i lejuar nxënësit të krijojnë lidhje dhe të shohin ndërlidhjen e disiplinave të ndryshme. Në projekte, nxënësit punojnë në ekipe, duke ndarë idetë, perspektivat dhe ekspertizën. Ata angazhohen në aftësi të menduarit të nivelit më të lartë, të tilla si aplikimi i njohurive, sintetizimi i informacionit dhe marrja e vendimeve. Kjo promovon zhvillimin kognitiv dhe përgatit nxënësit për sfida përtej klasës.

- *Projekti kurrikular nuk duhet të përmbajë njohuri të reja.*
- *Projekti kurrikular shtrihet përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat.*
- *Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në vëmendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.*
- *Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënësve që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.*
- *Për procesin e kualifikimit mësuesi organizon prezantimin e produkteve të nxënësve gjatë zhvillimit të projektit kurrikular.*

Statet kryesore që ndiqen për realizimin e projektit kurrikular janë:

- Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i



menaxhueshëm në kohë.

- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
- Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

Shembull projekti kurrikular me shtrirje vjetore, për lëndën e TIK (AMU)

1. **Tema e projektit** “Evoluimi i internetit dhe shërbimeve elektronike”
2. **Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore:** Projekti do të zgjasë gjatë tri periudhave të realizuara në 3 orë mësimore në lëndën e TIK-ut, të planifikuara 1 orë për çdo periudhë
Klasa/t pjesëmarrëse: Klasa e IX-a,b,c,d,
3. **Rezultatet e të nxënës** – Në përfundim të projektit nxënësi:
 - demonstroi njohuritë e marra për grumbullimin e të dhënave lidhur me evoluimin e internetit dhe masivizimin e shërbimeve elektronike;
 - lexon dhe kupton të dhënat e grumbulluara mbi nivelin e përdorimit të shërbimeve elektronike;
 - interpreton të dhënat dhe konsolidon njohuritë mbi ngjarjet dhe ndodhitë, të cilët ndikuan në përhapjen e gjerë të shërbimeve elektronike;
 - zgjedh dhe përdor mjetin TIK të përshtatshëm për të ndarë dhe për të shkëmbyer informacione dhe bashkëpunon me të tjerët në mënyrë të sigurt;
 - paraqet dhe komunikoi idetë e hartuara duke përdorur standardet e modelimit dhe të dizajnimit duke përfshirë teknologjitë digjitale;
 - përdor terminologjinë e duhur të TIK-ut për të përshkruar, analizuar, dhe vlerësuar rëndësinë e internetit dhe shërbimeve elektronike në jetën e përditshme;
 - prezanton para të tjerëve projektin për temën e dhënë, duke gërshetuar format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik;
 - bashkëpunon me shokët për realizimin e projektit dhe kontribuon pozitivisht me grupin.
4. **Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:**
 - qëllimi i studimit;
 - pyetësi, intervista;
 - grumbullimi i të dhënave lidhur me përdorimin e internetit dhe shërbimeve elektronike;
 - përpunimi i të dhënave;
 - tabelat, diagramet;
 - interneti;
 - paraqitja grafike e të dhënave;

- interpretimi i të dhënave, prezantimi i tyre.

5. Partnerët që do marrin pjesë në projekt – prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënës të shkollës, mësues etj.

6. Veprimtaritë kryesore:

- Diskutim me nxënësit lidhur me përzgjedhjen e temës së projektit.
- Ndarja e klasës në grupe sipas dëshirës së nxënësve në bashkëpunim me mësuesen.
- Zgjedhja nga nxënësit e detyrës hulumtuese për secilin grup.
- Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit.
- Hartimi i planit të veprimtarive për secilin grup.
- Kërkime njohurish të nevojshme në literaturën e rekomanduar, apo në internet në mënyrë që nxënësit të shfaqin aftësitë e tyre hulumtuese dhe studimore.
- Hulumtimi lidhur me zhvillimin e internetit që në fazat e para të krijimit të tij.
- Hartimi i pyetësorit lidhur me nivelin e përdorimit të internetit dhe shërbimeve elektronike.
- Grumbullimi i informacionit nga pyetësorët, (intervistat), komunikimi me mësuesit, prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënësit sipas popullatës së përzgjedhur.
- Përpunimi i të dhënave.
- Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij.
- Hartimi i draftit përfundimtar të projektit si rezultat i punës në grup dhe individuale.
- Prezantimi i produktit përfundimtar dhe dorëzimi i punës që ka bërë gjithsecili nga nxënësit.

7. Burimet kryesore të informacionit:

- Informacioni i marrë nga plotësimi i pyetësorëve
- Materiale të marra nga interneti
- Teksti mësimor i TIK-ut
- Tekste të tjera lëndore që lidhen me situatën konkrete.

Baza materiale:

- Interent
- Videoprojektor

- Kartonë, letra me ngjyrë
- Lapustila

8. *Tematika e orëve të planifikuara:*

- *Ora 1.* Përzgjedhja e temës së projektit. Ndarja e grupeve. Përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup. Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit brenda grupit përkatës, afatet dhe personi përgjegjës.
- *Ora 2.* Diskutimi i planit të veprimtarive të projektit, hartimi dhe diskutimi i pyetësorëve Përpunimi i materialit të grumbulluar, zhvillimi i të dhënave nga kërkime të ndryshme, etj. Shpërndarja e pyetësorëve në atë kampion ku është planifikuar të zhvillohet. Grumbullimi i informacionit nga pyetësorët, grumbullimi i materialit nga burime të tjera.
- *Ora 3:*Prezantimi i materialit të përgatitur. Vlerësimi i punës në grup dhe individual i nxënësve.

9. *Përshkrimi i produktit të projektit*

Projekti do të përqendrohet në hulumtimin e informacionit lidhur me evoluimin e internetit qënga fazat e para të krijimit të tij dhe me masivizimin e shërbimeve elektronike. Për të realizuar këtë projekt nxënësit do të mbledhin informacione që lidhen me detyrën hulumtuese që ka secili grup. Detyra hulumtuese ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave lidhur me nivelin e përdorimit të internetit dhe shërbimeve elektronike nga grupmosha të caktuara.


Projekti do të shkruhet dhe prezantohet nga secili grup sipas formatit të caktuar më poshtë:

- Tema e projektit
- Rezultatet e të nxënësit
- Tabela e planit të veprimtarive që ka realizuar secili grup me afatet dhe personat përgjegjës. Kjo tabelë lidhet edhe me detyrat që ka realizuar secili anëtar i grupit. Një shembull tabele e planit të veprimtarive paraqitet më poshtë:

Faza e parë		
Veprimtaria që do të realizohet	Afati	Anëtar i grupit
P.sh. Hulumtimi i të dhënave lidhur me zhvillimin e internetit dhe shërbimeve elektronike	15 tetor 201..	Anëtar i
.....		
P.sh. Hartimi i pyetësorit dhe përcaktimi i grupeve të kampionimit.	20 tetor 201...	Anëtar i
.....		
Faza e dytë		
P.sh. Grumbullimi i materialit nga burime të tjera	10 Janar 202..	Anëtar i
.....		
P.sh. Seleksionimi i të dhënave dhe përpunimi i materialeve	2 shkurt 202...	Anëtar i
.....		
Faza e tretë		
P.sh. Shkrimi i materialit	9 mars 202..	Anëtar i
.....		
P.sh. Punimi i materialit në kompjuter	3 prill 202...	Anëtar i
.....		
P.sh. Përgatitja e projektit për prezantim	15 prill 202..	Anëtar i ...
.....		

- Konceptet kryesore që janë përdorur gjatë zhvillimit të projektit.
- Përshkrim i shkurtër i projektit.
- Gjetjet e projektit. (*Gjetjet mund të paraqiten me mënyra të ndryshme: mund të shkruhen në një poster; mund të paraqiten në fletë formati dhe të prezantohen vetëm me gojë, mund të prezantohen me mjete audio-vizuale, me program kompjuterik power point, nëse është produkt, prezantohet produkti etj.*)
- Konkluzione të projektit.

10. Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi



Vlerësimi i nxënësve bëhet sipas tabelës 3 për vlerësimin e projekteve kurrikularë të përcaktuar sipas niveleve të mësipërme. Gjatë vlerësimit merret në konsideratë:

- Vetëorientimi dhe vetëdrejtimi i nxënësve në grup.
- Përdorimi i burimeve të ndryshme të mbledhjes së informacionit.
- Gjetja e zgjidhjeve në situatën të ndryshme dhe arsyetimet intuitive.
- Përdorimi i saktë i koncepteve të TIK-ut.
- Përzgjedhja e teknikave të përshtatshme kërkimore.
- Angazhimi i secilit nxënës në realizimin e projektit, individualisht dhe në progresin e grupit.
- Mënyra e prezantimit të projektit, i cili të lexohet, të dëgjohet dhe të kuptohet qartë.
- Rezultatet e projektit, nëse janë të qarta dhe të kuptueshme.

Shembull projekti kurrikular me shtrirje vjetore, për lëndën e TIK (AML)

1. Tema e projektit “Studimi i një Baze të Dhënash(BDH)”

2. Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore: Projekti do të zgjasë gjatë tri periudhave të realizuara në 3 orë mësimore në lëndën e TIK-ut, të planifikuara 1 orë për çdo periudhë **Klasa/t pjesëmarrëse:** Klasa e XI-a,b,c,d,

3. Rezultatet e të nxënës – Në përfundim të projektit nxënësi:

- demonstroi njohuritë e marra për funksionimin e bazave të të dhënave;
- prezantoi të dhënat në përshtatje me temën, redaktonte dhe ndan ide dhe informacione.
- prezantoi studimin e bazave të të dhënave para një audiencë të gjerë .
- përzgjedh saktë të dhënat për studimin e bazave të të dhënave nga burime të ndryshme në bazë të temës së projektit.
- përdori me saktësi komandat e avancuara të programeve standarde për përpunimin e të dhënave në një BDH.
- propozoi alternativa të ndryshme sesi qytetarët mund të kontribuojnë në këtë projekt studimi BDH.
- zgjedh dhe përdori mjetin TIK të përshtatshëm për të ndarë dhe për të shkëmbyer informacione dhe bashkëpunon me të tjerët në mënyrë të sigurt;
- paraqet dhe komunikoi idetë e hartuara duke përdorur standardet e modelimit dhe të dizajnimit duke përfshirë teknologjitë digjitale;
- përdori terminologjinë e duhur të TIK-ut për të përshkruar, analizuar, dhe vlerësuar rëndësinë e internetit dhe shërbimeve elektronike në jetën e përditshme.
- prezantoi para të tjerëve projektin për temën e dhënë, duke gërshetuar format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik;
- bashkëpunon me shokët për realizimin e projektit dhe kontribuon pozitivisht me grupin.

4. Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- qëllimi i studimit;
- Krijimi i një BDH
- Përdorimi saktë i komandave për ndërtimin dhe plotësimin e tabelave me rekorde.
- Kërkimi i informacionit.
- Krijimi i quer ,formave raporteve për një tabelë.
- Krijimi i query-ve për 2 tabelat të lidhura me një fushë të njëjtë.

- Ruajtja e tabelava, query-ve, formave dhe raporteve në programin Access.
- interpretimi i të dhënave, prezantimi i tyre.

5. Partnerët që do marrin pjesë në projekt – prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënës të shkollës, mësues etj.

6. Veprimtaritë kryesore:

- Diskutim me nxënësit lidhur me për zgjedhjen e temës së projektit.
- Ndarja e klasës në grupe sipas dëshirës së nxënësve në bashkëpunim me mësuesen.
- Zgjedhja nga nxënësit e detyrës praktike për secilin grup.
- Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit.
- Hartimi i planit të veprimtarive për secilin grup.
- Kërkime njohurish të nevojshme në literaturën e rekomanduar, apo në internet në mënyrë që nxënësit të shfaqin aftësitë e tyre praktike dhe studimore.
- Hulumtimi lidhur me krijimin dhe funksionimin e bazave të të dhënave .
- Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij.
- Hartimi i draftit përfundimtar të projektit si rezultat i punës në grup dhe individuale.
- Prezantimi i produktit përfundimtar dhe dorëzimi i punës që ka bërë gjithsecili nga nxënësit..

7. Burimet kryesore të informacionit:

- Informacioni i marrë nga plotësimi i pyetësorëve
- Materiale të marra nga interneti
- Teksti mësimor i TIK-ut
- Tekste të tjera lëndore që lidhen me situatën konkrete.

Baza materiale:

- Interent
- Videoprojektor
- Libri TIK-ut
- Literaturë plotësuese
- Lapustila

8. *Tematika e orëve të planifikuara:*

- *Ora 1.* Përzgjedhja e temës së projektit. Ndarja e grupeve. Përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup. Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit brenda grupit përkatës, afatet dhe personi përgjegjës.
- *Ora 2.* Diskutimi i planit të veprimtarive të projektit, hartimi dhe diskutimi i punëve të ndara. Përpunimi i materialit të përgatitur, zhvillimi i të dhënave nga kërkime të ndryshme. Nxënësit paraqesin punën e bërë gjatë kësaj faze të projektit. diskutohet me grupet e punës mbi kërkimet e kryera, informacionin e grumbulluar, a është në përputhje me temën, si është bërë përzgjedhja dhe përpunimi i tij nga secili grup. - diskutimi mësues-nxënës dhe nxënës-nxënës i ndihmon ata të përfitojnë ide nga sugjerimet e njëri- tjetrit; çdo nxënës dorëzon produktin e punës së tij sipas detyrës së përcaktuar brenda grupit.
- *Ora 3:* Prezantimi i materialit të përgatitur. Vlerësimi i punës në grup dhe individual i nxënësve.

9. *Përshkrimi i produktit të projektit*


Projekti do të përqendrohet në mbledhjen e informacioneve nga burime të ndryshme, dhe aplikimin e tyre në një detyrë praktike lidhur me krijimin e një baze të dhëne relacionale ndërmjet programit Microsoft Access. Nxënësit do të përcaktojnë saktë kriteret për ndërtimin e queryve, krijimit të formave dhe raporteteve, si dhe të zbatojnë me përpikmëri këshillat për një studim të saktë të BDH.

Projekti do të shkruhet dhe prezantohet nga secili grup sipas formatit të caktuar më poshtë:

- Tema e projektit
- Rezultatet e të nxënit
- Tabela e planit të veprimtarive që ka realizuar secili grup me afatet dhe personat përgjegjës. Kjo tabelë lidhet edhe me detyrat që ka realizuar secili anëtar i grupit. Një shembull tabele e planit të veprimtarive paraqitet më poshtë:

Faza e parë		
Veprimtaria që do të realizohet	Afati	Anëtar i grupit
Psh. Hulumtimi i të dhënave lidhur me krijimin e databasave dhe përpunimin digjital të të dhënave në programin Microsoft Access.	15 tetor 201..	Anëtar i
.....		
Psh. Përzgjedhja e tipologjisë dhe studimi i mjedisit për krijimin dhe dizajnimin e bazës së të dhënave. (bibliotekë, shkollë, supermarket, spital etj...)	20 tetor 201...	Anëtar i
.....		
Faza e dytë		
Psh. Grumbullimi i materialeve nga burime të tjera dhe aplikimi i njohurive në përgatitjen e draftit paraprak të databasës së krijuar.	10 Janar 202..	Anëtar i
.....		
Psh. Përpunimi i materialit dhe shtimi i funksionaliteteve të reja në databasë	2 shkurt 202...	Anëtar i
.....		
Faza e tretë		
Psh. Përmirësimi i mjedisit të databasës relacionale dhe testimi i queryve.	9 Mars 202..	Anëtar i
.....		
Psh. Punimi i materialit në kompjuter	3 Prill 202...	Anëtar i
.....		
Psh. Përgatitja e projektit për prezantim	15 Prill 202..	Anëtar i ...
.....		

- Konceptet kryesore që janë përdorur gjatë zhvillimit të projektit.
- Përshkrim i shkurtër i projektit.

- 
- Gjetjet e projektit. (*Gjetjet mund të paraqiten me mënyra të ndryshme: mund të shkruhen në një poster; mund të paraqiten në fletë formati dhe të prezantohen vetëm me gojë, mund të prezantohen me mjete audio-vizuale, me program kompjuterik power point, nëse është produkt, prezantohet produkti etj.*)
 - Konkluzione të projektit.

10. Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi

Vlerësimi i nxënësve bëhet sipas tabelës 3 për vlerësimin e projekteve kurrikularë të përcaktuar sipas niveleve të mësipërme. Gjatë vlerësimit merret në konsideratë:

- Vetorientimi dhe vetëdrejtimi i nxënësve në grup.
- Përdorimi i burimeve të ndryshme të mbledhjes së informacionit.
- Gjetja e zgjidhjeve në situatën të ndryshme dhe arsyetimet intuitive.
- Përdorimi i saktë i koncepteve të TIK-ut.
- Përzgjedhja e teknikave të përshtatshme kërkimore.
- Angazhimi i secilit nxënës në realizimin e projektit, individualisht dhe në progresin e grupit.
- Mënyra e prezantimit të projektit, i cili të lexohet, të dëgjohet dhe të kuptohet qartë.
- Rezultatet e projektit, nëse janë të qarta dhe të kuptueshme.

Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

Model instrument i vlerësimit të projektit kurrikular

Kriteret për vlerësimin e projektit kurrikular vjetor				
Gjithsej 40 pikë				
Kriteret e vlerësimit	Niveli 1 – Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
	0-2 pikë	3-6 pikë	7-9 pikë	10-12 pikë
Aftësitë kërkimore/hulumtuese.	Nxënësit rrallëherë përqendrohen te detyra e tyre. Ata mbledhin informacione pa gjetur zgjidhje të përshtatshme.	Nxënësit dalin jashtë temës dhe nuk përqendrohen vetëm te detyra e tyre. Ata mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje me ndihmë.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre shumicën e kohës. Ara mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre. Ata orientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. Nxënësit mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe komentojnë për të zgjidhur probleme.
Demonstrimi i tyre (12 pikë)	Nxënësit përdorin një burim për të gjetur informacione.	Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përdorin të paktën tre burime të ndryshme për të gjetur informacione.
Analiza dhe interpretimi i të dhënave,	0-2 pikë	3-5 pikë	6-8 pikë	9-10 pikë
	Nxënësit rrallëherë përdorin teknika	Nxënësit ndonjëherë përdorin teknika	Nxënësit zakonisht përdorin teknika	Nxënësit përdorin gjatë gjithë projektit teknika të

fakteve, ngjarjeve etj. Zgjedhja dhe zbatimi i teknikave të përshtatshme (10 pikë)	<i>të përshtatshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban shumë gabime.</i>	<i>të përshtatshme, por jo në mënyrë të vazhdueshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban disa gabime të rëndësishme.</i>	<i>teknika të përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban pak gabime.</i>	<i>përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja nuk përmban gabime.</i>
Aftësitë e prezantimit: Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit (18 pikë)	0-5 pikë <i>Në prezantimin e nxënësve materiali është i çorganizuar dhe rrëmujë. Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri-tjetrin.</i> <i>Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.</i>	6-9 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë mirë punën e tyre. Prezantimi jo gjithmonë të krijon lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.</i>	10-14 pikë <i>Në prezantimin e tyre nxënësit organizojnë mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.</i>	15-18 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë shumë mirë punën e tyre që të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Rezultatet e projektit prezantohen qartë.</i>



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tiranë

Shqipëri

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

